



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 110

Tiranë – E premte, 27 korrik 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 88/2018, datë 23.7.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 34, datë 20.5.2010, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” 6797
Vendim i Kuvendit nr. 89/2018, datë 23.7.2018	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore..... 6800
Rezolutë e Kuvendit datën 23.7.2018	Për reformën e politikës shtetërore për diasporën..... 6800
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 24, datë 19.7.2018	Për dhënien në përdorim falas dhe kthimin e teksteve shkollore për nxënësit e klasave I–IV të arsimit bazë..... 6802
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 49, datë 13.6.2018	Për fillimin e procedurës për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a..... 6804
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 51, datë 6.7.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 40, datë 23.9.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë” 6805
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 52, datë 6.7.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë”..... 6805
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 53, datë 6.7.2018	Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Has..... 6806

Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 82, datë 17.5.2018	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për skemën e incentivave fiskale në sektorin e turizmit”	6807
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 83, datë 25.6.2018	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja”	6811
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 84, datë 25.6.2018	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të inovacionit”	6812
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 85, datë 25.6.2018	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ndërmarrjeve sociale”	6814
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10106, datë 19.7.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “P4_C2_d Kopshti i sekreteve, Kënd lojërash (<i>Garden of secrets</i>) në lagjen “Uji i Ftohtë”, Vlorë”	6816
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 22/7, datë 20.7.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ‘Sul Misiri’”, në Bashkinë Elbasan.....	6818
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 1681/4, datë 20.7.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës paralel me murin rrethues të Portit”, në Bashkinë Durrës.....	6820
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Agim Lami.....	6820
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ramë Met Xhafaj.....	6820

**VENDIM
Nr. 88/2018****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 34,
DATË 20.5.2010, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE
KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE
TË PUNËS TË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe nenit 21, pika 3, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me propozimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Lidhja nr. 1 e vendimit të Kuvendit nr. 34, datë 20.5.2010, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.


II. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 34, datë 20.5.2010, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Efektet financiare shtesë do të përballohen nga buxheti i shtetit për vitin 2019.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.7.2018

*Lidhja nr. 1***STRUKTURA E ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**



Lidhja Nr. 2

**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS
TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

I. Komisioneri	1	I-D
		Ligji nr.10221, datë 04.02.2010
II. Kabineti	2	
Këshilltar	1	II-b
Sekretar	1	VKM 187/2017, pika 6
III. Drejtoria e Pritjes së Ankesave	6	
Drejtor	1	II-b
Specialist	2	IV-a
Specialist – Shkodër	1	IV-a
Specialist – Korçë	1	IV-a
Specialist – Fier	1	IV-a
IV. Drejtoria e Hetimit Administrativ	6	
Drejtor	1	II-b
Inspektorë	5	III-b
V. Drejtoria Juridike	5	
Drejtor	1	II-b
Specialist	4	III-b
VI. Drejtoria e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit	6	
Drejtor	1	II-b
Specialist i Marrëdhënieve me Jashtë	1	III-b
Specialistë të Monitorimit dhe Raportimit	2	III-b
Specialist i Komunikimit me Mediat	1	III-b
Specialist i Jetësimit të Projekteve	1	III-b
VII. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	8	
Drejtor	1	II-b
Specialist i burimeve njerëzore	1	III-b
Specialist IT	1	III-b
Specialist i Buxhet-Financës	1	III-b
Specialist i Arkiv-Protokollit	1	IV-a
Magaznier/punonjës mirëmbajtje	1	Kl. (VKM nr.717,dt.6.2009) i ndryshuar
Shofer	1	Kl. (VKM nr.717,dt.6.2009) i ndryshuar
Pastrues	1	Kl.(VKM nr.717,dt.6.2009) i ndryshuar

Gjithsej:**34 punonjës**



VENDIM
Nr. 89/2018

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REALIZIMIN E REFORMËS
ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore zgjatet për një periudhë 6-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 23.7.2018

REZOLUTË

PËR REFORMËN E POLITIKËS
SHTETËRORE PËR DIASPORËN

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar hapat e hedhur në ndërtimin e strukturave të politikës shtetërore për diasporën;

- Duke vlerësuar reformën legislative kushtuar komuniteteve shqiptare jashtë vendit dhe konkretisht miratimin brenda një periudhe të shkurtër të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe ligjit nr. 32/2018, “Për Fondin e Zhvillimit të Diasporës”;

- Duke konsideruar veprimtarinë shtetërore në këtë fushë si të një rëndësie të veçantë, e cila lidh përgjegjësitë e shtetit shqiptar me statusin ligjor të shtetasve dhe bashkëkombësve tanë jashtë vendit;

- Duke vlerësuar bashkëpunimin me shtetin e Kosovës dhe vendeve të tjera fqinje, në këtë drejtim të rëndësishëm dhe strategjik për të ardhmen, si pjesë e procesit të integritetit evropian të rajonit;

- Duke i konsideruar të rëndësishme propozimet e Nënkomisionit për Diasporën në lidhje me:

- Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 nga Këshilli i Ministrave si një dokument kyç për veprimin dhe aplikimin e politikave të reja të institucioneve shtetërore në këtë fushë të veprimtarisë shtetërore.

- Nisjen sa më shpejt të funksionimit të institucioneve të krijuara nga legjislacioni i ri i miratuar për këtë qëllim.

- Bashkëpunimin institucional, në mënyrë të veçantë, me shtetin e Kosovës për të përcaktuar një politikë të qëndrueshme dhe afatgjatë në funksion të interesave të komuniteteve shqiptare aty ku ata jetojnë, në vendet pritëse.

- Punën paraprake të Komisionit të Reformës Zgjedhore, në programin e diskutimit të të cilit një nga çështjet për t’u diskutuar dhe vendosur është dhënia e së drejtës së votës shtetasve shqiptarë, të cilët banojnë jashtë vendit.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave që me rastin e vitit të Gjergj Kastrioti Skënderbeut të organizohet në Tiranë aktiviteti i Samitit të Dytë të Diasporës Shqiptare.

Duke vërejtur dhe vlerësuar se:

- Në vitin 2017–2018, në Kryesinë e Kuvendit janë organizuar disa aktivitete në funksion të interesave të diasporës dhe migracionit. Këto takime publike kanë qenë një rast për ta bërë të ndjeshme edhe më shumë për nivele të ndryshme të politikës dhe administratës garantimin e të drejtave kushtetuese të diasporës dhe migracionit.

- Krijimi i një kanali televiziv “TVSH 3” nga Radio Televizioni Publik i Shqipërisë në zbatim të ligjit “Për diasporën” është një hap i rëndësishëm për forcimin e komunikimit me bashkëkombësit jashtë vendit.

- Fillimi i punës nga Muzeu Kombëtar, në bazë të ligjit të ri “Për diasporën”, për hapësirën brenda tij kushtuar historikut të diasporës shqiptare, është një detyrim ligjor dhe moral ndaj shtetasve të shoqërisë shqiptare që e ka ndihmuar vendin nga distanca e mërgimit. Shembujt e kësaj ndihme vlejné edhe sot në kushtet e një shoqërie globale, ku ruajtja e identitetit është detyrë dhe sfidë shtetërore.

- Miratimi nga ministratë përgjegjëse të arsimit të Shqipërisë dhe të Kosovës i



“curriculumave” të arsimit në diasporë është një hap i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit kulturor e arsimor shqiptar në diasporë. Kjo punë e nisur duhet të përfundojë me realizimin e librave mësimorë të nevojshëm për brezin e ri të shqiptarëve të mërguar.

- Organizimet kulturore në diasporë kanë filluar të kenë një rol të dorës së parë në ruajtjen e identitetit jashtë vendit. Ngritja e qendrave të kulturës në diasporë, sipas legjislacionit të ri dhe në bashkëpunim me shtetin e Kosovës, në funksion të marrëveshjeve bilaterale midis dy shteteve, do të ndihmojnë në krijimin e një programi kulturor të përbashkët për bashkëkombësit dhe brezat e rinj në diasporë.

- Ministria për Evropën dhe Politikën e Jashtme ka ndërmarrë veprime të rëndësishme në fushën e shërbimeve konsullore për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Shërbimet *online* kanë lehtësuar dhe shkurtuar procedurat burokratike në shërbimet konsullore. Kjo ministri ka firmosur dhe po negocion marrëveshje të rëndësishme për cilësinë e jetës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit, siç janë ato në fushën e sigurimeve.

- Krijimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në zbatim të legjislacionit të ri për diasporën, është hap i rëndësishëm në ruajtjen e identitetit dhe arsimit për shqiptarët e rinj larg vendlindjes. Kjo qendër do të shërbejë si një cilësi e re në fushën e publikimeve dhe shpërndarjes së librit për diasporën.

- Për shtetasit që janë larguar nga vendi ekziston një numër i ulët botimesh *online*, në gjuhën shqipe. Në këtë drejtim kërkohet një bashkëpunim institucional të ministrive përgjegjëse të arsimit, kulturës dhe diasporës për të gjetur zgjidhjet dhe krijuar rezultatet.

- Marrëdhënia e Shqipërisë me diasporën po ndjen nevojën e bashkëpunimit me inteligjencën dhe fuqinë punëtore të kualifikuar jashtë vendit.

- Përfshirja e diasporës në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Shqipërisë është një sfidë administrative. Fillimi i punës për krijimin e Dhomës së Biznesit për Diasporën është një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur.

Kërkon:

- Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin krijuar me vendimin nr. 98/2017 të Kuvendit të Shqipërisë si tregues i vëmendjes në rritje që Kuvendi, si institucioni më i lartë i vendit, i

ka dedikuar kësaj çështjeje, të ketë rol aktiv në ndjekjen e zbatimit të kuadrit ligjor për diasporën dhe të jetë një interlokutor, në emër të Kuvendit, për verifikimin dhe informimin me ecurinë e reformës në fushat të cilat ai mbulon.

- Angazhimin në vazhdimësi nga institucionet dhe agjencitë përgjegjëse të administratës në vlerësimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018–2024.

- Zgjidhjen e së drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit me mekanizma ligjorë nga Komisioni i Reformës Zgjedhore, duke u bazuar në modelet e njohura perëndimore, në bashkëpunim me OSBE–ODIHR-in.

- Bërjen funksionale në bazë të legjislacionit të miratuar, të organizimit institucional dhe strukturave shtetërore për diasporën, brenda vitit 2018.

- Koordinimin me institucionet përgjegjëse në fushën e diasporës të shtetit të Kosovës për hedhjen e hapave të përbashkët, në një marrëdhënie ku është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi me shtetet e tjera fqinje dhe rajon.

- Krijimi i një programi të veçantë nga ministritë përgjegjëse për arsimin, kulturën dhe diasporën për botimet *online* në fushën e arsimit dhe librit shqip, për të cilin komisionet përgjegjëse në Kuvendin e Shqipërisë të kërkojnë informacion periodik për fazat e realizimit të tij.

- Nxitjen e organeve të vetëqeverisjes vendore për të mundësuar aksesin e diasporës, me qëllim shkurtimin e “distancave” administrative me shtresën popullsisë që nuk jeton brenda vendit.

- Paraqitjen dhe/ose ndërmarrjen e nismave të nevojshme nga organet kompetente për rishikimin e ligjit “Për shtetësinë” dhe kuadrit ligjor përkatës për t’iu përgjigjur shqetësimeve të shtetasve shqiptarë jashtë vendit dhe fenomenit të “pashtetësisë”, të ngritur nga struktura përgjegjëse e OKB-së për këtë çështje, zyra e UNCHR-së në Tiranë.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson si të nevojshme diskutimin dhe vlerësimin periodik të çështjeve që kanë të bëjnë me diasporën dhe interesat e shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Ai konsideron se në kushtet e reja sociale dhe procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, dallimet e shtetasve, të cilët jetojnë “jashtë” dhe “brenda” vendit, janë ngushtuar. Ato kërkojnë përgjigje ligjore dhe administrative të duhura.



Diaspora është pasuria kombëtare e Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë është i përkushtuar që kjo të kthehet në një realitet të prekshëm nga qytetarët që kanë votuar apo që do të votojnë nesër për të ardhmen e përbashkët.

Miraturar në datën 23.7.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi

UDHËZIM
Nr. 24, datë 19.7.2018

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM FALAS
DHE KTHIMIN E TEKSTEVE
SHKOLLORE PËR NXËNËSIT E
KLASAVE I–IV TË ARSIMIT BAZË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 26 dhe të nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të gjithë nxënësit e klasave I–IV të arsimit bazë të marrin në përdorim falas të gjitha tekstet shkollore, sipas katalogut të teksteve shkollore, me detyrimin që tekstet shkollore të listuara në shtojcën 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, t’i dorëzojnë në fund të vitit shkollor.

2. Tekstet shkollore të klasave I–IV, të cilat janë pronë e njësive arsimore vendore, të përdoren për një periudhë kohore deri në tri vite shkollore.

3. Njësitë arsimore vendore dhe drejtoritë e shkollave publike janë strukturat përgjegjëse për pajisjen me tekstet shkollore në përdorim falas të të gjithë nxënësve të klasave I–IV në shkollat e varësisë.

4. Drejtori i shkollës publike ngrre Komisionin e Administrimit të Teksteve Shkollore në përdorim falas, si strukturë që kryen të gjithë veprimtarinë e marrjes në dorëzim të teksteve shkollore, sipas porosisë së dhënë, kthimit dhe

rishpërndarjes të nxënësve. Komisioni kryesohet nga drejtori i shkollës, ndërsa numri i anëtarëve përcaktohet në varësi të numrit të nxënësve për klasat I–IV në shkollë, por jo më pak se dy anëtarë.

5. Porosia të botuesi/distributori bëhet zyrtarisht nga drejtori i shkollës, pas procedurës zyrtare të përzgjedhjes nga titujt e katalogut dhe konfirmohet nga drejtuesi i njësive arsimore vendore.

6. Botuesit/distributorët bëjnë furnizimin drejtpërdrejt në shkollë, sipas porosisë zyrtare të marrë. Furnizimi duhet të përfundojë detyruesisht 10 (dhjetë) ditë kalendarike para datës së fillimit të vitit shkollor.

7. Botuesi/distributori lidh kontratë me drejtuesin e njësive arsimore vendore për respektimin e afateve të furnizimit të shkollave me tekstet shkollore që do t’u jepen në përdorim falas nxënësve të klasave I–IV të arsimit bazë.

8. Drejtori i shkollës nënshkruan faturat tatimore të çdo furnizimi të bërë nga botuesit/distributorët, sipas sasisë së porositur. Originali i faturës tatimore, i nënshkruar nga drejtori i shkollës, dorëzohet në njësinë arsimore vendore për likuidimin financiar të subjektit furnizues, jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga data e lëshimit të faturës. Drejtori i shkollës ruan fotokopje të çdo fature tatimore.

9. Drejtori i shkollës, brenda 15 ditësh kalendarike nga fillimi i vitit shkollor, njofton botuesin/distributorin për tekstet e pashpërndara (mbetur gjendje në shkollë), të cilat duhet t’i kthehen botuesit/distributorit në gjendjen fillestare. Për vlerën e teksteve të kthyera, plotësohet fatura përkatëse për kthimin e mallit, faturë që nënshkruhet nga drejtori i shkollës.

10. Drejtori i shkollës është përgjegjës për pajisjen në kohë me tekstet shkollore të të gjithë nxënësve përfitues të regjistruar në atë shkollë. Komisioni i Administrimit të Teksteve Shkollore në përdorim falas i dorëzon me procesverbal çdo mësuesi kujdestar për klasat I–IV tekstet shkollore për çdo nxënë. Mësuesi kujdestar e pajis çdo nxënë me të gjitha tekstet shkollore njëherësh, sipas regjistrimit në klasën përkatëse, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së fillimit të vitit shkollor. Drejtori i shkollës organizon punën për mbajtjen e aktit të dorëzimit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur dhe



pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për marrjen e teksteve shkollore nga nxënësit e çdo klase. Akti i dorëzimit hartohet në 2 (dy) kopje dhe nënshkruhet nga drejtori i shkollës, nga mësuesi kujdestar dhe nga njëri prej prindërve apo përfaqësuesi ligjor i nxënësit. Njëra nga kopjet e aktit të dorëzimit ruhet në drejtorinë e shkollës, ndërsa kopja tjetër dorëzohet në njësinë arsimore vendore përkatëse.

11. Çdo mësues ngarkohet të porositë nxënësit dhe t'i kontrollojë ata në vazhdimësi, që në tekstet shkollore ku shkruhet, të bëjnë shënime vetëm me laps, që mund të fshihet dhe nuk e bëjnë tekstin të papërdorshëm.

12. Drejtoria e shkollës është e detyruar të krijojë dhe të ruajë regjistrin e nxënësve për tekstet e dhëna në përdorim falas, sipas klasave. Çdo lëvizje nxënësish pasqyrohet detyrimisht në këtë regjistër. Ky regjistër bën pjesë në dokumentacionin e shkollës. Për mbajtjen dhe përditësimin e tij mban përgjegjësi drejtori i shkollës.

13. Kthimi i teksteve shkollore të dhëna në përdorim falas, sipas shtojcën 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të posaçëm të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

14. Ky udhëzim zbatohet nga viti shkollor 2018–2019 dhe në vijim.

15. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njësitë arsimore vendore, shtëpitë botuese/distributorët dhe shkollat publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

SHTOJCA 1

Klasa I:

1. Abetare (libri i nxënësit);
2. Matematika 1 (libri i nxënësit);
3. Dituri natyre 1 (libri i nxënësit);
4. Edukim për shoqërinë 1 (libri i nxënësit).

Klasa II:

1. Gjuha shqipe 2 (libri i nxënësit);
2. Matematika 2 (libri i nxënësit);
3. Dituri natyre 2 (libri i nxënësit);
4. Edukim për shoqërinë 2 (libri i nxënësit).

Klasa III:

1. Gjuha shqipe 3 (libri i nxënësit);
2. Matematika 3 (libri i nxënësit);
3. Dituri natyre 3 (libri i nxënësit);
4. Qytetaria 3 (libri i nxënësit);
5. Gjuha angleze 3 (libri i nxënësit);
6. Gjuha frënge 3 (libri i nxënësit);
7. Gjuha italiane 3 (libri i nxënësit);
8. Gjuha gjermane 3 (libri i nxënësit).

Klasa IV:

1. Gjuha shqipe 4 (libri i nxënësit);
2. Matematika 4 (libri i nxënësit);
3. Dituri natyre 4 (libri i nxënësit);
4. Qytetaria 4 (libri i nxënësit);
5. Historia 4 (libri i nxënësit);
6. TIK 4 (libri i nxënësit);
7. Gjuha angleze 4 (libri i nxënësit);
8. Gjuha frënge 4 (libri i nxënësit);
9. Gjuha italiane 4 (libri i nxënësit);
10. Gjuha gjermane 4 (libri i nxënësit).



SHTOJCA 2

AKT DORËZIMI

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

NJËSIA ARSIMORE VENDORE _____

SHKOLLA _____

KLASA _____

NXËNËSI _____

PRINDI/PËRFAQËSUESI LIGJOR _____

(emër, mbiemër, firma)

Marrë në dorëzim nga nxënësi në fillim të vitit shkollor 201_–201_ tekstet:			Dorëzuar nga nxënësi në fund të vitit shkollor 201_–201_ tekstet:		
Nr.	Teksti	Gjendja	Nr.	Teksti	Gjendja
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					

Data e marrjes në dorëzim nga nxënësi _____ Mësuesi kujdestar _____ Drejtori i shkollës _____ (emër, mbiemër, firma dhe vula)	Data e dorëzimit nga nxënësi _____ Mësuesi kujdestar _____ Drejtori i shkollës _____ (emër, mbiemër, firma dhe vula)
--	---

VENDIM

Nr. 49, datë 13.6.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MARRJEN E MASAVE
ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SHA**

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe të raportit nr. 80, datë 11.6.2018, përgatitur nga grupi i inspektimit, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. ka detyrime të pashlyera të pagesës rregullatore ndaj Entit Rregullator të Ujit, në vlerën 1 412 100 (një milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë deri në datën 31.12.2017, të cilat burojnë nga kontrata mes Entit Rregullator të Ujit dhe Ujësjiellës-Kanalizime, e datës 26.7.2010 e në vazhdim.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. nuk zbaton vendimet e ERRU-së për tarifën. Vendimi për miratimin e tarifave për ujin e pijshëm ka hyrë në fuqi në datën 1.1.2010 dhe janë të vlefshme deri në miratimin e tarifave të reja, ndërsa vendimi për miratimin e ujërave të ndotura ka hyrë në fuqi në datën 1.7.2014 dhe ka



qenë i vlefshëm për një afat kohor të caktuar deri më 1.7.2015.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e marrjes së masave administrative ndaj Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. për kundërvajtjet administrative:

a) Mospagimi i detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator të Ujit;

b) Për moszbatim të vendimeve të ERRU-së për tarifën;

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë nga marrja e këtij vendimi për të paraqitur kundërshtimet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 51, datë 6.7.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 40, DATË 23.9.2016, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME LUSHNJË”

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”; të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe të rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike-Ekonomike, mbi aplikimin e

shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 40, datë 23.9.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë”.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë ka aplikuar me anë të shkresës nr. 706 prot., datë 27.6.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor.

- Aplikimi i shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit, mbi ndryshimin e drejtuesit ligjor, konkretisht:

- dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- drejtuesi ligjor plotëson kriteret e parashikuara në rregulloren e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 40, datë 23.9.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë”, bëhet ky ndryshim:

“Drejtues ligjor: Erjet Dhima”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 52, datë 6.7.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 6, DATË 3.2.2017, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME GJIROKASTËR”

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”; të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe të rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë



8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër sh.a., për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër”.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër ka aplikuar me anë të shkresës nr. 976 prot., datë 21.6.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit, mbi ndryshimin e drejtuesit ligjor, konkretisht:

- dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- drejtuesi ligjor plotëson kriteret e parashikuara në rregulloren e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër” bëhet ky ndryshim:

“Drejtues ligjor: Dhimitri Kristidhi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 53, datë 6.7.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJIJELLËS-KANALIZIME HAS

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”; të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe të rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Has, për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Has, me NUIS: J66702907H, është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 24, datë 2.11.2009, “Për rinovim licence Ujësjiellës-Kanalizime Has”, me vlefshmëri 4-vjeçare deri në datën 2.11.2013.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Has, me anë të shkresës nr. 68 prot., të datës 12.6.2018, ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim, për arsye të përfundimit të afatit të licencës dhe të shtimit të kategorisë së largimit të ujërave të ndotura.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Has plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:

- formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar i plotë;

- në lidhje me drejtuesin teknik, shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Has duhet që brenda dy viteve nga marrja e licencës, të sigurojë drejtues teknik që i plotëson kriteret e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të



licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Has, me:

Drejtues ligjor: z. Xhemil Thaçi

Drejtues teknik: z. Hajredin Cahani

2. Operatori sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Has autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar, në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zonat e shërbimit të këtij operatori janë njësitë administrative të Bashkisë Has, njësitë administrative: Krumë, Gjinaj, Fajza.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 82, datë 17.5.2018

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “PËR SKEMËN E INCENTIVAVE FISKALE NË SEKTORIN E TURIZMIT”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

z. Arben Ahmetaj	kryetar;
znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
znj. Etleva Haka	anëtare;
znj. Mirjana Zisi	anëtare;
z. Ahmet Mançellari	anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 17.5.2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar; të nenit 28/1, “Autorizimi *ex-post* i ndihmës”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe

formën e njoftimit””, vlerësoi përputhjen me rregullat e ndihmës shtetërore të skemës së incentivave fiskale në sektorin e turizmit.

1. Procedura

Me qëllim mbështetjen e aktivitetit ekonomik të shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, si edhe hoteleve me “status special”, vendës dhe të huaj, dhënësit e ndihmës kanë miratuar më akte ligjore dhe nënligjore dhënie e incentivave fiskale, me qëllim mbështetjen e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve në Shqipëri, në sektorin e turizmit. Publiku dhe operatorët ekonomikë kanë akses në informacion për skemën e ndihmës shtetërore, duke qenë se masa e sipërcituar është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19 dhjetor 2017 dhe nr. 232, datë 28 dhjetor 2017. Komisioni vendosi të shqyrtojë këtë masë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së saj me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

1.1 Bazat për iniciimin e procedurës

Në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni vlerëson se incentivat fiskalë janë ndihmë shtetërore. Ky konkluzion paraprak mbështetet në gjetjet, se:

- përjashtimi nga tatimi mbi fitimin për kohëzgjatjen prej 10 vitesh; përjashtimi nga taksa mbi ndërtesat; aplikimi i shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar nga 20% në 6%, për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese “hotel/resort me pesë yje, status special”; si edhe aplikimi i shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar nga 20% në 6%, për çdo furnizim shërbimi të ofruar nga strukturat akomoduese, do t’u japë përfituesve të ndihmës një avantazh ekonomik që nuk ofrohet në treg, në kushte normale;

- avantazhi i dhënë është selektiv, sepse vetëm përfituesit/ndërmarrjet do të përfitojnë nga skema e ndihmës;

- avantazhi jepet nga burimet shtetërore, duke qenë se lehtësirat do të rezultojnë në uljen e të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit dhe; se

- lehtësirat fiskale të dhëna për ndërmarrjet kanë efekt në konkurrencë dhe ndikon në tregtinë në rajon.

2. Përshkrimi i masës



2.1 Objektivi i skemës së ndihmës shtetërore

Skema synon të inkurajojë investimet në infrastrukturën e turizmit në Republikën e Shqipërisë, si edhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Dhënësi i ndihmës është Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Zbatues i skemës së ndihmës shtetërore është ministria përgjegjëse për turizmin.

2.2 Përfituesi nga skema e ndihmës shtetërore

Plani për dhënien e ndihmës shtetërore në formën e incentivave fiskalë përbëhet nga dy komponentë:

I. Skema e ndihmës shtetërore për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, në formën e reduktimit të shkallës së tatimit mbi vlerën e shtuar nga 20% në 6%; si dhe

II. Skema e ndihmës shtetërore për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese “hotel/resort me pesë yje, status special”, në formën e reduktimit të shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar nga 20% në 6%, përjashtimit nga tatimi mbi fitimin (për një kohëzgjatje prej 10 vitesh), si dhe përjashtimi nga taksa e ndërtesës.

Përfituesit nga zbatimi i skemës së ndihmës shtetërore janë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e akomodimit në strukturat akomoduese, si dhe operatorët menaxhues në strukturat akomoduese “me 4 ose 5 yje, status special”, të cilat marrin përsipër operimin dhe menaxhimin e një strukture akomoduese me 4 ose 5 yje.

Skema nuk zbatohet për ndërmarrjet në vështirësi në kuptimin të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim’”.

2.3 Baza ligjore e skemës së ndihmës shtetërore

Në Fletoret Zyrtare nr. 222, datë 19 dhjetor 2017 dhe nr. 232, datë 28 dhjetor 2017, janë publikuar aktet e mëposhtme:

I. Për skemën e I, baza ligjore është:

Ligji nr. 71/2017, “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar’”, të ndryshuar, neni 1. ku përcaktohet se:

“3. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit

të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind.”

II. Për skemën II, baza ligjore është:

a) Ligji nr. 114/2017, “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015, ‘Për turizmin’”.

- Neni 1 përcakton se:

“Investitor në strukturë akomoduese “me 4 ose 5 yje, status special”, nënkupton “subjektin i cili financon ndërtimin dhe/ose merr përsipër ndërtimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të strukturave akomoduese “me 4 ose 5 yje, status special”, në përputhje me këtë ligj”.

- Neni 2 përcakton se:

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për turizmin, jep statusin e veçantë, “investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special”, për subjektin që plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

“a) Është investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje në Republikën e Shqipërisë, të certifikuar si të tillë nga një agjenci e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për turizmin;

b) Vlera e investimit është të paktën 8 (tetë) milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 yje dhe të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 5 yje.”

b) Ligji nr. 106/2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar; neni 22, “Taksa mbi ndërtesat”, i cili parashikon në pikën 6, shkronja “e”, se përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

“Strukturat akomoduese “hotel/resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht *brand name*”.

c) Ligji nr. 105, datë 30.11.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, neni 2, i cili parashikon që në nenin 18, “Përjashtimet” të shtojë me germën “g”, subjektin që përjashtohet nga tatimi mbi fitimin:

“... Përjashtimi nga tatimi mbi fitimin, i parashikuar sipas këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024...”.



d) Ligji nr. 107/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 1, ku përcaktohet, se: Në nenin 49 “Shkallët e reduktuara”, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“Përfshirja sa përcaktohet në pikën 3 të këtij neni, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6% aplikohet për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese “hotel/resort me pesë yje, status special”.

2.4 Vlera e planifikuar e ndihmës shtetërore

Për ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e akomodimit në strukturat akomoduese, dhënësi i ndihmës do të raportojë vlerën e ndihmës shtetërore, në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 32, “Raportet vjetore”.

Efekti financiar në burimet shtetërore/në buxhetin e shtetit për strukturat akomoduese “hotel/resort me pesë yje, status special”, do të përlogaritet në momentin kur ndërmarrja do të operojë në fushën e turizmit.

3. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

3.1 Kualifikimi i skemës si ndihmë shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, përcaktohet, se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë, në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

Gjithashtu, neni 71, “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen

vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit (TFEU).”

Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar dhe të nenit 107(1) të TFEU-së, Komisioni vlerëson plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

- masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore,

- masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar, si edhe

- masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis shteteve anëtare.

Skema e incentivave fiskalë për ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e akomodimit në strukturat akomoduese dhe ndërmarrjet e strukturave akomoduese “hotel/resort me pesë yje, status special”, është ndihmë shtetërore, sepse përparësia jepet nga burime shtetërore, ka risk për të shtrembëruar konkurrencën, si edhe forcon gjendjen ekonomiko-financiare të ndërmarrjeve kundrejt konkurrentëve të tjerë në treg. Mbështetja për sektorin e turizmit në ekonomi ndikon në tregtinë mes shtetesh, sepse ndërmarrjet në sektorin e hotelevisë në shtetet e rajonit konkurrojnë për tërheqjen e turistëve.

4. Vlerësimi i përputhshmërisë së ndihmës shtetërore, në bazë të nenit 13, pika 3, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”

Komisioni vlerëson se plani i ndihmës synon nxitjen e investimeve në ekonomi, si edhe përmirësimin e aftësive menaxheriale në sektorin e turizmit, nëpërmjet përfshirjes së teknologjive të reja, si edhe në rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve shqiptare. Komisioni konstaton se nuk është e dhënë kohëzgjatja e skemës në vite, lidhur me reduktimin e shkallës së tatimit mbi vlerën e shtuar dhe taksës mbi ndërtesën.

Të dy komponentët e planit të ndihmës plotësojnë të gjitha kushtet e një ndihme operationale dhe, si e tillë, në parim, ajo është e ndaluar. Megjithatë, në bazë të nenit 7, të të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale’”, ndihma shtetërore mund të lejohet vetëm nëse plotësohen të tria kushtet e mëposhtme:

- ndihma është e justifikuar për shkak të natyrës së saj dhe për kontributin që jep në zhvillimin rajonal;

- vlera e saj është në përpjesëtim me mangësitë që kërkon të rregullojë;

- ndihma është e kufizuar në kohë dhe zvogëlohet në mënyrë progresive.

Komisioni vëren se skema nuk ka parashikuar mekanizmin e raportimit të zbatimit të saj dhe as kushtet kumulative që duhet të plotësojnë ndërmarrjet, nëse ato mbështeten nga forma të tjera të mundshme të ndihmës shtetërore.

Komisioni, mbi bazën e njoftimit të skemës së ndihmës nga ministria përgjegjëse për turizmin, do të shqyrtojë, vlerësojë dhe miratojë skemën e ndihmës operacionale për subjektin që do të përfitojë “statusin special”, të parashikuar në ligjin nr. 114/2017, “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015, ‘Për turizmin’”, vetëm nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

- a) Masa e ndihmës synon në arritjen e një qëllimi të përcaktuar mirë dhe me interes të përbashkët, duke provuar se:

- masa e ndihmës ka për qëllim përmbushjen e objektivit me interes të përbashkët;

- domosdoshmërinë për ndërhyrje shtetërore;

- b) Ndihma është një instrument i përshtatshëm dhe i domosdoshëm, duke provuar se:

- masa ka efekt nxitës,

- masa është proporcionale dhe e kufizuar (shuma e ndihmës duhet të sjellë rritje të treguesve të matjes së performancës në sektorin e turizmit;

- c) Efektet në konkurrencë dhe tregti do të jenë të kufizuara;

- d) Ndihma është transparente.

Nëse masa e njoftuar e ndihmës shtetërore plotëson kushtet e mësipërme, si dhe duke qenë se skema e ndihmës shtetërore në këtë vendim synon nxitjen e investimeve në veprimtari, sektorë dhe rajone të caktuara, Komisioni i Ndihmës Shtetërore do të shprehet për lejueshmërinë e saj në përputhje të plotë me

nenin 13, pika 3 dhe nenin 14, të ligjit nr. 9374, datë 21.0.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

Konkluzion

Sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se masa e njoftuar është ndihmë shtetërore, por është në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar; me nenin 13, pika 3, “Ndihma shtetërore që mund të lejohet”, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, 20, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore operacionale për ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e akomodimit në strukturat akomoduese dhe për ndërmarrjet që investojnë në strukturat akomoduese “me 4 ose 5 yje, me status special”, të parashikuar në ligjin nr. 114/2017, “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015, ‘Për turizmin’”, mbështetur në nenin 13, pika 3, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Ndërmarrjet përfutuese, në kuadër të skemës ose në kuadër të ndihmës individuale, do të duhet të deklarojnë çdo formë tjetër ndihme shtetërore që kanë përfutuar ose do të përfutojnë.

3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohej për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të



dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vite, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

4. Ministria përgjegjëse për turizmin në zbatim të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, të njoftojë dhe marrë autorizimin nga ana e Komisionit të Ndhmës Shtetërore siç është parashikuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, itë ndryshuar.

5. Ministria përgjegjëse për turizmin, bazuar në nenin 20, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

6. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 83, datë 25.6.2018

AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E
FONDIT NË MBËSHTETJE TË
SIPËRMARRJEVE TË REJA”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

z. Arben Ahmetaj	kryetar;
znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
znj. Etleva Haka	anëtare;
znj. Mirjana Zisi	anëtare;
z. Ahmet Mançellari	anëtar,

në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar; të nenit 28/1, “Autorizimi *ex-post* i ndihmës”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores Për procedurat dhe formën e njoftimit”, vlerësoi përputhjen me rregullat e ndihmës shtetërore të skemës së mbështetjes të ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme.

Objektivi i skemës së ndihmës: Skema synon të ndihmojë ndërmarrjet e reja të vogla dhe të mesme për funksionimin e tyre në treg.

Baza ligjore e skemës: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 210, datë 20.4.2018, “Për krijimin e fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja *start-up*”.

Komisioni shqyrtoi këtë masë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së skemës së sipërcituar me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe

VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës janë ndërmarrjet e reja të vogla dhe të mesme të regjistruara pranë QKB-së, që ushtrojnë veprimtari ekonomike që u përkasin fushave, si më poshtë:

- Sektorët prodhues e të shërbimit;
- Sektorin e industrisë së lehtë;
- Sektorin e turizmit;
- Fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;
- Procesin e agropërpunimit;
- Fushën e disenjimit, të modelimit dhe të artizanatit.

2. Ndihma do të jepet në formën e grantit nga buxheti i shtetit, me vlerë të përgjithshme prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, për një kohëzgjatje zbatimi prej 3 (tri) vitesh, për periudhën 2018–2020. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

3. Ndihma do të mbulojë 70% të kostove të pranueshme dhe të miratuara nga komisioni vlerësues, në varësi të projektit konkurrues dhe financim deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

4. Skema e miratuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 210, datë 20.4.2018, lejon si kosto të pranueshme:

- Investime në pajisje dhe teknologji për nxitjen e prodhimit/të shërbimit;
- Marketing të produktit dhe promovim (me përjashtim të reklamave elektronike e televizive);
- Kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive sipërmarrëse, të dëshmuar me certifikatat përkatëse;
- Krijim faqeje interneti dhe publikim materialesh promovuese;
- Pjesëmarrje në panaire ose ekspozita, brenda apo jashtë shtetit, si vizitor ose ekspozues.

5. Dhënës i ndihmës është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase do të jetë Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

6. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:



- Ndihma jepet nga buxheti i shtetit në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

- Skema është selektive, pasi nëpërmjet granteve u ofrohet përfituesve një avantazh konkurrues kundrejt konkurrentëve të tjerë aktivë, në të njëjtin sektor dhe redukton kostot e veprimtarisë së tyre.

- Skema lidhet me sektorë dhe ndërmarrje, të cilët janë të përfshirë në tregtinë me shtetet e rajonit dhe mund të ndikojë në tregtinë ndërshtetesh.

7. Në bazë të nenit 13, “Ndihma shtetërore që mund të lejohet”, pika 3, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, skema lejohet me kusht që zbatuesi i skemës AIDA t’i kërkojë përfituesit të ndihmës një planbiznesi, i cili duhet të përmbajë elementet si më poshtë:

- një përshkrim të detajuar, duke shpjeguar arsyet se pse ndërmarrja nuk do të mund të ushtrojë veprimtari në treg në mungesë të ndihmës;

- një plan financiar që tregon qëndrueshmërinë e biznesit pa ndihmë shtetërore pas tre vjetësh;

- kohën e nevojshme për fillimin e veprimtarisë tregtare të biznesit;

- numrin e punonjësve të punësuar çdo vit gjatë kohëzgjatjes së ndihmës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 13, pika 3; 22, pika 2; 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 210, datë 20.4.2018, “Për krijimin e fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja *start-up*”, sepse ndihma lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. AIDA t’i kërkojë çdo përfituesi të ndihmës paraqitjen e një plani biznesi, i cili duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- një përshkrim të detajuar duke shpjeguar arsyet se pse ndërmarrja nuk do të mund të ushtrojë veprimtari në treg në mungesë të ndihmës shtetërore;

- një plan financiar që tregon qëndrueshmërinë e biznesit pa ndihmë shtetërore pas tre vjetësh;

- kohën e nevojshme për fillimin e veprimtarisë tregtare të biznesit;

- numrin e punonjësve të punësuar çdo vit gjatë kohëzgjatjes së ndihmës.

3. AIDA të sigurojë që në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, nuk do të zbatohet skemën për ndërmarrjet në vështirësi, në kuptim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim’” dhe, se nga fondi i mbështetjes nuk do të përfitojnë ndërmarrjet me pasqyrë financiare me humbje.

4. AIDA të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vite, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 84, datë 25.6.2018

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E FONDIT TË INOVACIONIT”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

z. Arben Ahmetaj	kryetar;
znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
znj. Etleva Haka	anëtare;
znj. Mirjana Zisi	anëtare;
z. Ahmet Maçeallari	anëtar,

në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar; të nenit 28/1, “Autorizimi *ex-post* i ndihmës”, dhe të vendimit



të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, vlerësoi përputhjen me rregullat e ndihmës shtetërore të skemës së mbështetjes të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për nxitjen e projekteve të inovacionit.

Objekti i skemës së ndihmës: Skema synon të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në përmirësimin e teknologjisë dhe nxitjen e inovacionit.

Baza ligjore e skemës: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 20.4.2018, “Për krijimin e fondit të inovacionit”.

Komisioni shqyrtoi këtë masë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së skemës së sipërcituar me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe

VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të regjistruara pranë QKB-së, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në të gjithë sektorët e ekonomisë.

2. Ndihma do të jepet në formën e grantit nga buxheti i shtetit me vlerë të përgjithshme prej 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekësh, për një kohëzgjatje zbatimi prej 3 (tre) vitesh, për periudhën 2018–2020. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

3. Ndihma do të mbulojë 50% të kostove të pranueshme dhe të miratuara nga komisioni vlerësues, në varësi të projektit konkurrues, dhe financim deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë.

4. Skema e miratuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 20.4.2018, lejon si kosto të pranueshme:

a) Auditimin e kapacitetit inovativ dhe teknologjik, që synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante vlerësimin për nivelin ekzistues të teknologjisë dhe mundësitë për rinovimin e tyre të inovacionit dhe/ose pozicionimit teknologjik, sipas një strukture konkurruese zhvillimi;

b) Ndërkombëtarizimin e teknologjisë, e cila synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante të identifikojnë dhe të inspektojnë teknologjinë që kërkojnë të përshtatin;

c) Pjesëmarrjen në panairë inovacioni, teknologjie dhe promovimi, në lidhje me inovacione të ndërmarrjes;

ç) Blerje pajisjesh teknologjike, që ndikojnë në rritjen e kapaciteteve inovative dhe teknologjike të ndërmarrjes.

d) Licenca ose patenta (*software* ose *hardware*).

5. Dhënës i ndihmës është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase do të jetë Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

6. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- ndihma jepet nga buxheti i shtetit në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar;

- skema është selektive, sepse ndihma jepet për një numër të kufizuar ndërmarrjesh;

- skema ka efekt nxitës, sepse pritet përmirësim i treguesve, si: zgjerim i fushës së aktivitetit, i zbatimit më të shpejtë të projektit dhe i rritjes së shumës totale për inovacion;

- skema lidhet me sektorë dhe ndërmarrje, të cilët janë të përfshirë në tregtinë me shtetet e rajonit, dhe mund të ndikojë në tregtinë ndërshtetesh.

7. Në bazë të nenit 12, “Ndihma për kërkim, zhvillim dhe inovacion”, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, skema lejohet me kusht që zbatuesi i skemës AIDA të hartojë një plan vlerësimi, i cili duhet të përmbajë elementet si më poshtë:

- objektivat e skemës së ndihmës që duhen vlerësuar;

- pyetjet për vlerësimin e ndihmës;

- treguesit për matjen e rezultateve;

- metodologjinë e parashikuar për kryerjen e vlerësimit;

- të dhëna që lidhen me kohëzgjatjen e vlerësimit, duke përfshirë datën e dorëzimit të raportit përfundimtar të vlerësimit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 12, pika 1, shkronja “ç”, 22, pika 2, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,



VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 20.4.2018, “Për krijimin e fondit të inovacionit”, sepse ndihma synon nxitjen e projekteve të inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

2. AIDA të sigurojë që, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, nuk do të zbatohet skemën për ndërmarrjet në vështirësi në kuptim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim’” dhe, se nga fondi i inovacionit nuk do të përfitojnë ndërmarrjet me pasqyrë financiare me humbje.

3. AIDA të mbështesë projektet e inovacionit për mbulimin e kostove të pranueshme, si më poshtë:

- kostot për zotërimin, vërtetimin dhe mbrojtjen e patentave dhe të aseteve të tjera të paprekshme;

- kostot për vënien në dispozicion të personelit me kualifikim të lartë nga një organizatë kërkimi ose nga një ndërmarrje e madhe, e cila kryen aktivitete kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni, në një funksion të krijuar rishtazi brenda ndërmarrjes përfituese, pa zëvendësuar pjesëtarët e tjerë të stafit; si dhe

- kostot për këshillimet e inovacionit dhe shërbimet mbështetëse.

4. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të angazhohet për të kryer vlerësimin sipas planit të vlerësimit të përshkruar në këtë vendim dhe të të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

5. AIDA të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vite, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 85, datë 25.6.2018

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E
FONDIT TË NDËRMARRJEVE
SOCIALE”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

z. Arben Ahmetaj	kryetar;
znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
znj. Etleva Haka	anëtare;
znj. Mirjana Zisi	anëtare;
z. Ahmet Mançellari	anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 25.6.2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të dërguar me shkresën nr. 3463, datë 25.5.2018, për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale nëpërmjet subvencionit nga buxheti i shtetit i veprimtarisë së tyre.

Objekti i skemës së ndihmës: Skema synon mbështetjen e veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale, nëpërmjet subvencionit nga buxheti i shtetit, që të zhvillohen dhe të rriten në mënyrë që të mund të punësojnë sa më shumë individë nga grupet e pafavorizuara.

Baza ligjore e skemës: Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”.

Komisioni shqyrtoi planin e ndihmës shtetërore të sipërcituar, duke vlerësuar përputhshmërinë e saj me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe

VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës janë ndërmarrjet sociale të regjistruara në administratën tatimore, pasi janë pajisur më parë me vendimin e gjykatës dhe njohjen e statusit si ndërmarrje sociale, me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale,



që ushtrojnë veprimtari ekonomike në të gjithë sektorët e ekonomisë.

2. Ndihma do të jepet në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit, me vlerë të përgjithshme prej 249,760,000 lekësh dhe skema do të ketë një kohëzgjatje zbatimi prej 3 (tri) vitesh, për periudhën 2019–2021.

3. Ndihma do të mbulojë 70% të kostove të pranueshme dhe të miratuara nga komisioni vlerësues, por jo më shumë se 1,500,000 lekë, në rast se subjekti është në gjendje të financojë pjesën e mbetur të investimit.

4. Skema e propozuar në projektvendim, lejon si kosto të pranueshme:

a) Investime në makineri dhe pajisje për realizimin e prodhimit/shërbimit;

b) Kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara;

c) Mbulimin deri në 50% të pagës minimale për punonjësit e rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara për një periudhë 6-mujore.

5. Dhënës i ndihmës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

6. Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- Në kuptim të legjislacionit të ndihmës shtetërore, çdo njësi ekonomike e angazhuar në një aktivitet ekonomik (ofrimi i mallrave dhe i shërbimeve në një treg të caktuar) konsiderohet si një ndërmarrje, pavarësisht formës ligjore ose mënyrës së financimit. Pra ndërmarrjet sociale konsiderohen si ndërmarrje të angazhuara në një aktivitet ekonomik;

- Ndihma planifikohet të jepet nga buxheti i shtetit në kuptim të nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar;

- Skema është selektive, sepse ndihma jepet për një numër të kufizuar ndërmarrjesh sociale;

- Skema ka efekt nxitës, duke qenë se shumica e ndërmarrjeve sociale janë në pritje të sigurimit të të ardhurave të tyre nga alokimi i subvencioneve shtetërore. Subvencioni pritët të kompensojë produktivitetin e ulët që rezulton nga punësimi i personave me aftësi të kufizuara dhe i të papunëve afatgjatë;

- Skema lidhet me sektorë dhe ndërmarrje të cilët janë të përfshirë në tregtinë me shtetet e

rajonit dhe mund të ndikojë në tregtinë ndërshtetesh, në kushtet kur ekziston një nivel i konsiderueshëm i investimeve nga ndërmarrje të tjera të vogla dhe të mesme në vend.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 10, pika “a” dhe “b”; 13, shkronja “c”; 22, pika 2; 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore të parashikuar në projektvendimin e Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”, mbështetur në nenin 10 dhe 13, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse ndihma në formën e subvencionit të pagës jepet për punësimin e punëkërkuarve të papunë në vështirësi dhe punësimin e punëkërkuarve të papunë me aftësi të kufizuara dhe, se nëpërmjet saj lehtësohet zhvillimi i veprimtarive të caktuara ekonomike.

2. T’i propozojë Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sa më poshtë:

- Të listohen të gjithë përfituesit potencialë nga plani i ndihmës;

- Të përcaktohen kategoritë e aktiviteteve (sektorët e industrisë), të cilët kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë;

- Të përcaktohet një mekanizëm për monitorimin e ndihmës shtetërore, i cili duhet të përfshijë sanksionet e duhura financiare në formën e kthimit të ndihmës nga ndërmarrjet sociale që nuk do të respektojnë planin e biznesit. Ky mekanizëm duhet të përmbajë elementet si vijojnë:

- përkthimi i detajuar i kostove të pranueshme;

- dorëzimi i raporteve financiare;

- monitorimi i ndihmës së dhënë, me qëllim përmbushjen e objektivave për të cilët është miratuar, si edhe përmbushja e termave të kontratës;

- njohja e shpenzimeve vetëm mbi bazën e faturave të dorëzuara;

- kthimi i ndihmës në rast të konstatimit të parregullsive në përdorimin e ndihmës.



3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të pikës 16 të projektvendimit, të sigurojë që vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje sociale, e siguruar sipas kësaj skeme dhe skemave të tjera të mbështetjes nga buxheti i shtetit, nuk do të kalojë shumën 14,000,000 lekë, për një periudhë financiare prej tri vitesh. Për këtë, ministria duhet t'i kërkojë çdo përfituesi një deklaratë mbi çdo ndihmë *de minimis* (të miratuar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 67, datë 25.10.2016, “Për miratimin e deklaratës së dhënies së ndihmës *de minimis*”), të përfituar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitin financiar në vazhdim.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ndihmën në formën e subvencionit të pagës, duhet të konsiderojë si më poshtë:

- Në rastin kur punësimi nga skema e ndihmës nuk përfaqëson një rritje neto të numrit të të punësuarve në ndërmarrjen përfituese, në krahasim me mesataren gjatë 12 muajve të mëparshëm, vendi ose vendet e punës konsiderohen të lëna vakante, si rezultat i largimit vullnetar, për arsye të aftësive të kufizuara, daljes në pension në bazë të moshës, reduktimit vullnetar të orëve të punës ose të largimit të ligjshëm nga puna dhe jo si rezultat i largimeve/shkarkimeve nga vendet e punës.

- Me përjashtim të rasteve të shkarkimit të ligjshëm nga puna, punonjësit, në kushte të pafavorshme, kanë të drejtën e punësimit të vazhdueshëm për një periudhë minimale, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose me marrëveshjet kolektive që rregullojnë kontratat e punësimit.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e

skemës deri në dhjetë vite, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj

KËRKESË
Nr. 10106, datë 19.7.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “P4_C2_d Kopshti i sekreteve, kënd lojërash (*Garden of secrets*) në lagjen “Uji i Ftohtë”, Vlorë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, si dhe të udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të EKB-së Tiranë, për llogaritjen e vlerës së truallit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 41 085 717 (dyzet e një milion e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI
 “ P4_C2_d KOPSHITI I SEKRETEVE, KËND LOJËRASH (GARDEN OF SEKRETS) NE LAGJEN “UJI I FTOHTE”, VLORË”

Çmimi i truallit sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.

Çmimi për objektet sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të EKB-së Tiranë.

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Lloji i Pronës	Sipërfaqe trualli m ²	Çmimi i truallit, lekë/m ²	Vlera e truallit, lekë	Sipërfaqe ndërtimi m ²	Vlera e ndërtimit, lekë	Vlera truall dhe ndërtësë (lekë)	Shënime
1	8602	36/256	Vlorë	Adivije Lamaj, Drita Gabvrani, Faslli Hajro, Mjaflore Beqiraj, Mylyse Voshtina, Memli Xhaferi, Sadedin Xhaferi, Bernoreta Xhaferi dhe Faire Lloja	Truall	3562	10903	38,836,486	0.00		38,836,486	Ne seksionin D ka shënimin: me nr. dok. 021014, datë 20.4.2017, tipi k. hip: Regjistrohet aktmarrëveshja nr. 250 kol., datë 20. 4.2017, dhe kontrata e hipotekimit nr. 332 rep, nr. 251 kol., datë 20.4.2017, nëpërmjet shoqërisë “Lazaj” sh.p.k. dhe Faslli Hajro, për 1/2 pjesë. Te kapitulli “Përshkrimi i veçantë” është vënë shënim: Parcela prej 800 m ² është hapur te 36/ 257, pasi ndahet nga rruga. Te kjo pasuri bën pjesë edhe pasuria 36/249; 36/257, të cilat janë kufizuar për shkak të mbivendosjes. Këtu bëjnë pjesë edhe pasuritë 36/258, 36/25,9, të cilat janë hapur rrugë. Të zgjidhet problemi. Saktësim dokumentacioni.
2	8602	36/89	Vlorë	Fatbardha, Ferit, Mustafa, Nafize, Neire dhe Rezara Vokopola	Truall	145	10903	1,580,935	0.00		1,580,935	Në seksionin E ka shënimin: Ka 2 (dy) ndërtesa pa leje.
3	8602	36/99	Vlorë	Myqerem Hamzaraj	Pemëtore	136	204	27,744	0.00		27,744	Në seksionin E ka shënimin: Kufizim veprimesh deri në saktësimin e skicës.
4	8602	36/194	Vlorë	Shahin Bejdaj	Truall	6.5	10903	70,870	0.00		70,870	Në seksionin E ka shënimin: Rivlerësim pasurie 5,451,500.00 lekë. Vlen për 1 (një) transaksion. Në seksionin E ka shënimin: Diferencë dok. fakt. = 11.6 m ² .
5	8602	36/255	Vlorë	Fatbardha, Ferit, Mustafa, Nafize, Neire dhe Rezara Vokopola	Truall	52.25	10903	569,682	0.00		569,682	
VLERA TOTALE: 41,085,717												

**KËRKESË****Nr. 22/7, datë 20.7.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruktion i rrugës ‘Sul Misiri’”, në Bashkinë Elbasan.

Subjekti kërkues është Bashkia e Elbasanit. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së

masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi, me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 519.660 (pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko



TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA OBJEKTI “RIKONSTRUKSION I RRUGËS “SUL MISIRI”, BASHKIA ELBASAN

		Vërtetim pronësie				Truall			Ndërtesa				Njësi			SHPRONËSIMI	Vërejtje
Familja që shpronësohet	Nr.	m²			Shpron.	Çmimi	Shpronësim	Sip. ndertës. m²		Çmimi	Shpronësim	Sip. e njësisë m²	Çmimi	Shpronësim		SHUMA	
Liljana Sefer Musaj, Merita Sefer Musaj, Vera Sefer Musaj	pas.	truall	banesë	njësi	m²	lekë/ m²	lekë	preket	shpron.	lekë/ m²	lekë	preket	shpron.	lekë/m²	lekë	lekë	
	9/159	0.00	15.00	0.00	0.00	12764	0.00	15.00	15.00	34644	519660.00	0.00	0.00	62686	0.00	519660.00	Konfirmuar nga VRPP-ja
				0.00	0.00		0.00				519660.00		0.00		0.00	519660.00	

**KËRKESË****Nr. 1681/4, datë 20.7.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës paralel me murin rrethues të Portit”, në Bashkinë Durrës.

Subjekti kërkuar është Bashkia e Durrësit. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së

shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen, për efekt shpronësimi, me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 708.750 (shtatëqind e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

TABELA PËRMbledhëse e vlerësimit të shpronësimit për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private të cilat preken nga objekti: "Ndërtimi i rrugës paralel me murin rrethues të Portit", Bashkia Durrës

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sip. e objektit që shpronësohet m ²	Çmimi i ndërtesës për m ²	Vlera e përgjithshme në lekë	Nr. i shkresës së konfirmimit nga ZVRPP-ja Durrës
1	Mikel Asti Pepa	8514	4/418/N D-G	15	67500 x 0.7 = 47250	708750	1804/1, datë 16.3.2018

TOTALI**708750****VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5651, datë 29.6.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Agim Lami, i datëlindjes 4.7.1957, si dhe caktimin si kujdestarë për administrimin e pasurisë së tij, shtetasin Florind Lami, i datëlindjes 9.3.1991.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 587 (2557), datë 23.5.2018, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ramë Met Xhafaj, i datëlindjes 5.11.1939, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të shtetases Fatbardha Ymer Hykaj.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë